



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 68

Prishtinë, më 14.06.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević.

**Munguan:** Selviqe Halimi, Doruntinë Maloku, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Dren Ajeti-GLPS; Dredhëza Ahmetxhekaj-Rrokum TV; Taulant Osmani-Jeta në Kosovë; Dibran Istrefi-Klan Kosova; Arlinda Bajrami-Instituti GAP; Egzon Pacolli- Praktikant; Ardian Bajraktari- MD; Lumnije Murati- ZPRK; Albert Krasniqi dhe Mërgime Kajtazi- KDI.

**Nga stafi mbështetës:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 10 dhe 23.05 2016;
3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor i Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2015;
4. Rekomandimet e Ministrisë së Drejtësisë, Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për mbështetje buxhetore;
5. Shqyrtimi i Propozimit të Kryeprokurorit të Shtetit për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës;

6. Diskutim lidhur me emërimin e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Kuvendi;
7. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetarja propozoi që pika e tretë rendit të ditës të hiqet. Në pikën e katërt u shtua dhe 'Instituti Gjyqësor të Kosovës'. Te pika të ndryshme është një kërkesë për takim nga OJQ 'Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës'.

*Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara*

### **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 10 dhe 23.05.2016**

**Kryetarja** konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 10 dhe 23.05.2016, pa vërejtje.

### **3. Rekomandimet e Ministrisë së Drejtësisë, Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Institutit Gjyqësor të Kosovës për mbështetje buxhetore.**

**Kryetarja** paraqiti për diskutim rekomandimet e Ministrisë së Drejtësisë, Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Institutit Gjyqësor të Kosovës për mbështetje buxhetore dhe ftoj anëtarët e Komisionit të marrin fjalën.

**Armend Zemaj**- Në fjalën e tij tha se kjo pikë duhet të shqyrtohet si pikë e veçantë dhe të shohim para se të hyjmë në proces të rishikimit të buxhetit në bazë të mundësive tona se çfarë mbështetje mund t'i japim. Takimi që e kemi mbajtur ka treguar rezultatet e duhura dhe institucionet nuk janë kufizuar vetëm në kërkesat që i kanë paraqitur këtu, por janë zgjeruar në bazë të nevojave të tyre për avancimin e punës në sistemin e drejtësisë në përgjithësi.

**Krytarja**- Në fjalën e saj tha se arsyeja që kam vendosur këtë pikë në rendit të ditës është që t'i diskutojmë bashkë në Komision se cilat nga propozimet mund t'i përkrahim sepse ne e dimë ndonëse të gjitha ato propozime që janë bërë mund të konsiderohen tepër të rëndësishme dhe nuk mund të pranohen lehtësisht për shkak të problemeve buxhetore. Shqetësimet e tyre janë paraqitur te kategoritë financiare paga/mëditje, mallra/shërbime dhe investime kapitale. Kam shpejtuar që këtë çështje ta vendosi si pikë diskutimi në rend dite, sepse qëllimi im ka qenë që të përfshihen kërkesat e institucioneve të drejtësisë duke e ditur se operojnë me më pak se 2% të totalit të buxhetit, para se të vijë rishikimi i buxhetit.

**Agim Aliu**- Gjatë raportimeve për dy vite me radhë i kemi parë mangësitë buxhetore që i kanë dhe me kërkesën e Komisionit për Legjislacion janë ftuar institucionet që bien në fushëveprim të Komisionit për t'i paraqitur shqetësimet e tyre lidhur me buxhetin. Sigurisht që gjatë fjalës së përfaqësuesve të institucioneve kemi parë që kanë pasur kërkesa më shumë se sa që janë mundësitë, por kanë edhe kërkesa shumë elementare apo bazike që kanë dalë edhe si vërejtje që

ne i kemi pasur si Komision. Mendoj se ne duhet të dakordohemi që të paktën kërkesat elementare të këtyre institucioneve të plotësoheshin. E përkrah idenë që të diskutohet me një pikë të veçantë dhe para rishikimit të buxhetit dhe pas rishikimit të buxhetit.

*Meqë nuk kishte diskutime, Komisioni në mënyrë unanime në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2016 nxori këtë:*

## **V e n d i m**

### **Për formimin e grupit punues për shqyrtimin e rekomandimeve të institucioneve që bien në fushëveprim të Komisionit lidhur me kërkesat buxhetore për vitin 2016**

1. Formohet Grupi i punës në këtë përbërje:

Selvije Halimi – kryesues,  
Albulena Haxhiu- anëtare,  
Agim Ademaj- anëtar dhe,  
Milena Miliçiviq- anëtare.

### **4. Shqyrtimi i Propozimit të Kryeprokurorit të Shtetit për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës**

**Kryetarjaparaqiti** për shqyrtim propozimin e Kryeprokurorit të shtetit për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës. Ne kemi marrë vetëm një propozim dhe roli i Komisionit për legjislacion më tepër është formal edhe pse unë do të doja të kishim më shumë propozime, sepse sa herë diskutohet për këto çështje gjithmonë na vjen një propozim dhe kjo nuk është zgjedhje, por është emërim, tha znj. Haxhiu. Ajokërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

*Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash (4 vota **për**, 2 vota **abstenim**) vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

## **Rekomandim**

Të emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, kandidati:

1. Haxhi Dërguti, anëtar nga Prokuroria e shtetit;
2. Mandati anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës zgjat 2 (dy) vjet.

### **5. Diskutim lidhur me emërimin e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Kuvendi.**

**Kryetarja-** Në fjalën e saj tha se janë dy kandidatë të cilët kanë aplikuar për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e komunitetit serb. Siç e dini ish-anëtari i KGJK-së ka bërë

shkelje kushtetuese duke qenë anëtar i KGJK-së dhe njëkohësisht kandidat në listën e Vuçiqit në zgjedhjet nacionale të Serbisë dhe natyrisht Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka pasur për qëllim që t'i propozojë Kuvendit për shkarkim të tij, por ai ka dhënë dorëheqje nga anëtarë i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

*Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se anëtarët e Komisionit në mënyrë unanime u dakorduan që në një mbledhje të afërt për të cilën do të njoftohen me kohë të bëhet intervistimi i kandidatëve për anëtar të KGJK-së nga radhët e komunitetit serb.*

## **6. Të ndryshme**

### **A. Njoftim**

**Kryetarja-** I njoftoi anëtarët se Komisionit për legjislacion i ka ardhur një kërkesë për takim nga OJQ “Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës” për t’u informuar me problemet dhe sfidat që e preokupojnë këtë organizatë. Kryetarja propozoi që të mbahet një takim me këtë organizatë dhe në ditët në vijim anëtarët e Komisionit do të jenë të njoftuar se kur do të mbahet ky takim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:25.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**